



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Lenda : Vleresimi i Korporatave
Departamenti : Kontabilitet dhe Financa
Master

Msc. Valdrin Misiri

Pejë, Prill 2018

Vleresimi i Korporatave

- Viti I-të, Semestri II
 - Departamenti : KF - Master
 - Statusi i lëndes : Obligative
 - Javët mësimore: 15 [3 orë ligjerata, 2 orë ushtrime]
 - Mësimdhënes: Prof.Asoc. Dr. Rrustem Asllanaj
 - Asistent: MSc. Valdrin Misiri
 - Orari i ligjeratave: E premte (G1 – ora 15:00 – 17:15 A1)
 - Orari i ushtrimeve: E marte (G1 – ora 16:30 – 18:00 B1)
-
- E-mail: valdrin.misiri@unhz.eu
 - Website: www.unhz.weebly.com

Raporti P/E (Çmim/Fitim)

- Kjo racio reflekton shumën që duhet tu paguhet investitorëve për secilin euro të fitimit.
- Qasja e raportit P/E është teknikë e popullarizuar për vlerësimin e vlerës së aksioneve të firmës kur ajo shumëzohet me fitimin për aksion të pritshëm (EPS).
- EPS zakonisht shumëzohet me mesataren e P/E-së së industrisë. Burimet lidhur me mesataren i mbajnë (Standard and Poor's Industrial Ratios).

Raporti P/E (Çmim/Fitim)

- Kjo qasje është superiore ndaj qasjes së vlerës kontabël dhe vlerës së likuidimit.
- Raporti i cmimit ndaj fitimit shprehet si perpjestim krahasues ndërmjet cmimit dhe fitimit per aksion.
- I popullarizuar ne praktiken financiare me emertimin e njohur P/E, ai nuk perdoret per matjen e profitabilitetit, por per vleresimin e vleres se tregut te aksioneve.
- Si element kryesor, qe ndikon ne kete tregues eshte prespektiva e fitimeve te ardhshme.

Raporti P/E (Çmim/Fitim)

- Ky raport llogaritet permes kesaj formule:

- $$P/E = \frac{\text{Çmimi i tregut te aksioneve}}{\text{Fitimi per aksion (EPS)}}$$

- Sipas analisteve financiar raporti P/E eshte indikator per vleresimin e kualitetit te fitimit.
- Nje raport i P/E, relativisht i larte, tregon se tregu i miraton cmimet me te larta te aksioneve dhe anasjelltas.
- Po ashtu pranimi i cmimeve te aksioneve nga tregu mbeshtetet edhe tek performancat e ndermarrjes qe prezantohen ne P.A.

Shembull

- Korporata XYZ posedon 240.000 aksione me vlere nominale prej 2 € per aksion dhe vlere e tregut te ketyre aksioneve eshte 2.5 €. Te ardhurat neto te kesaj kompanie jane 88.000 €.
- Sa eshte raporti P/E?

Shembull

- Kompania “XYZ” e parashikon qe ne vitin 2016 fitimi për aksion të jetë 4,20€. Kjo pritje e cila eshte parashikuar bazohet në analizën e fitimit të realizuar në të kaluarën dhe nga kushtet e tregut se ku operon kompania. Raporti P/E për firmat në kete treg është 9.
- Përcaktoni vlerën e aksioneve të firmës?

Shembull

- Supozojmë se me 31.12.2016 çmimi i tregut për aksion është 20 euro. Pra, në fund të vitit 2016 kompania M ka në zotrim 4650 aksione te rregullta, ndersa fitimi neto i vitit 2015 është 64.000 euro.
- Llogaritni raportin P/E ?

Modeli për përcaktimin e çmimit të pasurisë kapitale (CAPM)

- Ky model përfaqëson teorinë bazike që ndërlidh së bashku rrezikun dhe kthimin për të gjitha pasuritë. Para se të përdoret ky model duhet të kuptohen llojet e rrezikut.
- Rreziku (risku) përfaqëson shancën për humbje financiare.
 1. Rreziku operativ (afarist)
 2. Rreziku financiar

Modeli për përcaktimin e çmimit të pasurisë kapitale (CAPM)

- Modeli i çmimit të pasurive kapitale (CAPM) është një model që përshkruan marrëdhëniet midis rrezikut sistematik dhe kthimit të pritshëm për asetet, veçanërisht aksionet.

Rreziku sistematik dhe jo sistematik (i pa diversifikueshëm dhe i diversifikueshëm)

- Rreziku sistematik matet me koeficientin beta. Beta është një indeks në shkallë të përqindjes i cili lëviz(ndryshon) kthimin e pasurisë si reagim i ndryshimit të kthimit të tregut.
- Beta është në vlerë të përqindjes zakonisht prej 0.5 deri në 2. Nëse beta është 0.5 praktikisht nënkupton se kthimi prej aksioneve pritet të ndryshoj me $\frac{1}{2}$ % për secilin ndryshim me 1 % në kthimin e portfolios së tregut.
- Këtë e masin psh: Standard & Poor.

Rreziku sistematik dhe jo sistematik (i pa diversifikueshëm dhe i diversifikueshëm)

- CAPM pohon se i vetmi rrezik i vleresuar nga investitoret potencial është risku sistematik, sepse është ky i vetmi risk i cili nuk mund të shmanget nepermjet diversifikimit.
- CAPM nenkupton se të gjithë investitoret do të mbajnë një portofolio të tregut duke kërkuar premium të riskut i cili do të jetë potencial me botën e tregut.

Modeli CAPM

- Qellimi themelor i nje firme eshte rritja e vleres se tregut te kapitalit aksionar. Ajo detyron firman qe gjate punes se saj, te zbatoje ate praktike e cila do te rrise vleren e aksioneve.
- Modeli i vleresimit te aktiviteteve te kapitalit CAPM inkuadron konceptin Beta me te cilin matet risku si relacion ndermjet levizjeve te nje letre specifike me vlere dhe levizjeve te tregut te pergjithshem te letrave me vlere.
- Sipas ketij modeli CAPM norma e pritur e kthimit nga nje projekt eshte e barabarte me:

Modeli CAPM

Capital Asset Pricing Model (CAPM)

$$\begin{aligned} \underbrace{K_e} &= \underbrace{R_F} + \underbrace{(R_M - R_F)} \times \underbrace{\beta} \\ \text{Cost of Equity} &= \text{Risk Free Rate} + \left(\text{Market Risk Premium} \right) \times \text{Beta} \end{aligned}$$

$$\bar{r}_a = r_f + \beta_a(\bar{r}_m - r_f)$$

Where:

r_f = Risk free rate

β_a = Beta of the security

\bar{r}_m = Expected market return

Kthimi i pritur nga nje leter me vlere = norma pa risk + (kthimi i pritur nga tregu – norma pa risk) x beta

Modeli CAPM

- $k_j = R_F + [b_j x (R_m - R_F)]$
- **k_j** = kthimi i kerkuar ndaj pasurisë j
- **R_F** = kthimi pa rrezik i cili zakonisht matet me kthimin e bonove të thesarit
- **b_j** = koeficienti beta ose indeksi i rrezikut sistematik për pasurinë j
- **R_m** = kthimi i tregut, përkatësisht kthimi në portfolion e tregut të pasurisë

Modeli për përcaktimin e çmimit të pasurisë kapitale (CAPM)

- Ideja e përgjithshme pas CAPM është se investitorët duhet të kompensohen në dy mënyra: vlera në kohë e parase dhe rreziku.
- Vlera kohore e parase përfaqësohet nga norma e rrezikut (r_f) në formulë dhe kompensohet investitorët për vendosjen e parave në ndonjë investim për një periudhë kohore.
- Norma pa rrezik, zakonisht është rendimenti mbi obligacionet qeveritare si psh bonat e thesarit të SHBA-ve.

Modeli për përcaktimin e çmimit të pasurisë kapitale (CAPM)

- Gjysma tjetër e formulës CAPM paraqet rrezik dhe llogarit shumën e kompensimit që investitori ka nevojë për marrjen e rrezikut shtesë.
- Kjo llogaritet duke marrë një masë rreziku (beta) që krahason kthimet e aktivitetit në treg gjatë një periudhe kohore dhe primit të tregut ($R_m - r_f$): kthimi i tregut që tejkalon normën pa rrezik .
- Beta reflekton se sa i rrezikshëm është një aset krahasuar me rrezikun e përgjithshëm të tregut dhe është një funksion i luhatshmërisë së aktivitetit dhe tregut, si dhe korrelacionit midis tyre. Për aksionet, tregu zakonisht përfaqësohet nga S & P 500, por mund të përfaqësohet edhe nga indekse më të fuqishme.

Modeli CAPM


- Modeli i CAPM thotë se kthimi i pritshëm i një letre me vlere ose i një portofoli është i barabartë me normën e një letre me vlere pa rrezik, plus një pritje rreziku.
- Nëse ky kthim i pritur nuk plotëson ose nuk e tejkalon kthimin e kërkuar, atëherë investimi nuk duhet të ndërmerret. Linja e tregut të letrave me vlere përmban rezultatet e CAPM për të gjitha rreziqet e ndryshme (beta)

Modeli CAPM

- Modeli CAPM i vlerësimit të letrave me vlerë supozon se këto letra shiten në një treg perfekt të kapitalit.
- Modeli varet nga këto kushte:
 1. Risku i padëshiruar
 2. Risku sistematik (koeficienti beta)
 3. Premia e riskut në treg
 4. Nuk ka kosto të transaksioneve dhe tatime
 5. Të gjithë investitorët mund të marrin dhe të japin hua me cfardo shume

The Capital Asset Pricing Model

Expected and Required Rates of Return



C is an overvalued portfolio. Expected return is less than the required return.

Selling pressure will cause the price to fall and the yield to rise until expected equals the required return.

equals required
(market equilibrium condition is achieved.)

Shembull

- Korporata XYZ zhvillon nje produkt teknologjik dhe dëshiron të përcaktoj kthimin e kërkuar të pasurisë X e cila ka betën me 1.35. Norma e kthimit pa rrezik është 5 %, kthimi i portfolios së tregut të pasurisë është 8 %.
- Atëherë sa është rendimenti i kthimit të kërkuar sipas ekuacionit CAPM?

Shembull

- Kompania N dëshiron të kalkuloj koston e kapitalit përmes modelit CAPM. Analistët e firmës N tregojnë se norma pa rrezik e kthimit është 9%, Beta=1.55 dhe kthimi i tregut është 10%.
- Llogaritni koston e kapitalit aksionar nëpërmjet modelit CAPM?

Pyetje



Suksese!